



Kolegji ESLG

Në bazë të nenit 56 të statutit të Kolegjit ESLG dhe në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të Rregullores për Pranimin e Studentëve në programet master dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2018 për gjuhët e huaja në programin e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë si dhe në bazë të nevojave të Kolegjit ESLG për regjistrimin e studentëve për vitin akademik 2019/2020 në nivelin master, Rektori i Kolegjit ESLG miratoi si në vijim:

VENDIM

- I. Kandidatët të cilët aplikojnë për regjistrim në nivelin master të studimeve në Kolegjin ESLG duhet të dëshmojnë njohuri të njëjës prej gjuhëve të shënuara mëposhtë:
 - a) Angleze;
 - b) Gjermane;
 - c) Frënge;
 - d) Italiane;
 - e) Spanjolle;
- II. Studentët duhet të ofrojnë dëshmi të njohurive në nivelin B1 ose Certifikim ndërkombëtar TOEFL.
- III. Studentët e regjistruar janë të obliguar që të sjellin dëshmitë para fillimit të vitit akademik sipas paragrafit paraprak;
- IV. Kandidatët të cilët nuk posedojnë dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja të njëjtit munden ti nënshtrohen çertifikimit në gjuhën angleze në Shkollën Profesionale të UBT-së e cila është e akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe i licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ose nga ndonjë prej shkollave profesionale të çertifikuara për dhënien e çertifikimeve për gjuhë të huaj sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2018. Këtë dëshmi munden ta sjellin deri në përfundim të vitit akademik 2019/2020.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

Rektori i Kolegjit ESLG

Doc. Dr. Visar Hoxha



Kolegji ESLG
Nazim Gafurri 33
10000 Prishtina Kosovo
Tel: 038 602 405
M: 045 456 666
E-mail: info@eukos.org